



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 14318 Prot.

Lezhë, më 30.07.2021

VENDIM

Nr. 116 Datë 29.07.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E VITIT 2021

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1.Miratimin e një ndryshimi në buxhetin e bashkisë për vitin 2021 si më poshtë:

1/a-Në programin buxhetor “Rrjeti Rrugor”,Kodi “04520” të bëhen këto ndryshime :Pakësohet fondi prej 11,970,612 lekë për objektin: “Rehabilitim i qendrave të fshatrave Shënkoll, Zejmen, Kolsh, Balldre, Gocaj dhe Blinisht”.

1/b-Të shtohet shpenzimet në programin buxhetor “Mbrojtja nga Zjarri e Shpëtimi”, Kodi ‘03280’ në shumën prej 11,970,612 lekë, i cili do të përdoret për: “Blerjen e një zjarrfikëse të re, për nevoja të bashkisë”.

Për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:

- Pakësohet : Gr.00, Prog.04520, Kap.05, Art.231 në shumën 11,970,612 lekë.
- Shtohet : Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art.231 në shumën 11,970,612 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

